H.A.N.A

HAND TO HAND AGAINST NATION APATHY

PROPOZIMET

E PARAQITURA PËR PLANIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2028

ndaj Bashkisë Lezhë

#1

Sot transporti shkollor në Lezhë paguhet nga prindërit. Bashkia duhet të marrë përgjegjësinë dhe të garantojë mbulim real, pa përjashtime.

Mbështetje & rimbursim për nxënësit & mësuesit që jetojnë larg shkollave

NGA PYETËSORI

Sa ju kushton transporti në muaj për të ardhur në shkollë?



Të mbulohet ose **subvencionohet** transporti shkollor:

Nxënësit e arsimit fillor – mbi 2.5 km distancë.
2. Nxënësit e arsimit 9-vjeçar/ të mesëm – mbi 5 km distancë.
3. Mësuesit – për shkak të kushteve të njëjta me nxënësit.
4. Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara – pa kushte distance.

Përfitimet:

-Akses i barabartë në arsim.
-Ulje e braktisjes, sidomos në zonat rurale.
-Lehtësim i barrës financiare të familjeve/mësuesve.
-Rritje e përgjegjësisë së bashkisë ndaj qytetarëve.

Krijimi i një mekanizmi transparent për mbledhjen dhe përdorimin e kontributeve vullnetare

#2

Kjo duhet **të përfshijë** :

1. Regjistrim zyrtar i çdo pagese për nxënës.
2. Publikim periodik i shpenzimeve dhe fondeve në nivel shkolle.
3. Përfshirja e bordeve të prindërve në vendimmarrjen për përdorimin e tyre.
4. Ndërhyrje të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak për ta bërë pjesë të Planit 3-vjeçar të Arsimit Parauniversitar (2026–2028).
5. ZVAP dhe DRAP të ngarkohen me monitorim dhe raportim të rregullt.

ZVAP dhe DRAP të ngarkohen ligjërisht dhe praktikisht me monitorimin dhe raportimin e këtyre kontributeve në nivel shkolle dhe bashkie.

Familjet janë të ekspozuara ndaj detyrimeve të fshehura, që nuk janë pjesë e buxhetit zyrtar të arsimit.

Bashkia, si autoritet përgjegjës për Planin e Arsimit 2026–2028, duhet të garantojë barazi, transparencë dhe kontroll mbi çdo kontribut.

Pa këtë rregullim, Këshilli Bashkiak legjitimon një praktikë që rrezikon të shndërrohet në pagesë të detyruar dhe jo vullnetare.

#3

Çdo shkollë në territorin e bashkisë, urbane ose rurale, duhet të ketë të paktën një rojë sigurie të paguar

sipas kriterit më poshtë:

Siguria është e drejtë themelore, jo luks. Nuk ka kuptim që fëmijët në zonat rurale të jenë të trajtuar si "më pak të rëndësishëm" se ata në qytet.
Një politikë e barabartë sigurie do të rrisë besimin e prindërve, do të ulë pasiguritë e nxënësve dhe do të forcojë rolin e bashkisë si garant i shërbimeve bazë.

Përfshirja në planin 3-vjeçar të arsimit (2026–2028) është e domosdoshme për të mos mbetur vetëm premtim verbal, por detyrim politik e buxhetor.

NGA PYETËSORI

A ndiheni të sigurt në ambientet e shkollës suaj?



Numri i rojeve të përcaktohet sipas numrit të nxënësve, por **asnjë** shkollë nuk mund të ketë më pak se shkolla **më e vogël** urbane që sot ka roje sigurie.

Fokus te grupet vulnerabël: Siguri shtesë për shkollat që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, duke garantuar jo vetëm akses fizik, por edhe mbrojtje.

Transparencë dhe monitorim: Bashkia të publikojë një listë të plotë të shkollave me roje dhe pastruese të financuar nga buxheti publik, që qytetarët të dinë qartë se ku shpenzohen paratë e tyre.

#4 Depolitizimi i shkollave dhe monitorimi i komunikimit publik

Monitorimi i kryer nga H.A.N.A. në periudhën 2023–2025 tregon se fenomeni i politizimit të faqeve online të shkollave publike në Lezhë është real dhe shqetësues:

- 2023–2024: Nga 33 shkolla të monitoruara, 22 publikuan postime të politizuara. Nga gjithsej 4,401 postime, 1,931 ishin politike (43.9%).
- 2024–2025 (deri në mesin e vitit): Ka një rënie të dukshme – vetëm 143 nga 851 postime ishin politike (16.8%).

Këto shifra tregojnë përmirësim, por problemi nuk është zhdukur. Politizimi i komunikimit të shkollave bie ndesh me nenin 8 të ligjit për depolitizimin, i cili ndalon përdorimin e institucioneve publike për propagandë politike.

1. **Neutralitet absolut** – ndalimi i përdorimit të shkollave e faqeve online për promovim politik (zbatim i nenit 8).
2. **Masa disiplinore** – paralajmërim dhe përgjegjësi administrative për shkollat që përsërisin shkeljet.
3. **Protokoll komunikimi** – miratim i udhëzimeve të qarta mbi përmbajtjen e lejuar.
4. **Raportim transparent** – publikimi periodik i përmbajtjes online dhe i nivelit të politizimit.
5. **Monitorim i pavarur** – bashkëpunim me shoqërinë civile për kontroll e sugjerime.

Bashkia dhe Këshilli Bashkiak kanë mundësinë ta përfshijnë këtë masë në Planin 3-vjeçar të Arsimit Parauniversitar (2026–2028), duke **e bërë pjesë** të politikave të detyrueshme lokale.

#5

Pajisja e secilës shkollë 9-vjeçare & të mesme në Lezhë me një laborator shkencor të dedikuar

1. **Çdo** shkollë duhet të ketë laborator të pajisur të fizikës, kimisë dhe teknologjisë së informacionit **(IT)**.
2. Pajisje bazë dhe materiale të konsumueshme – sigurimi i mikroskopëve, aparaturave matëse, reaktivëve, kompjuterëve dhe softuerëve mësimorë.
3. Monitorim nga Bashkia – krijimi i një mekanizmi **të rregullt** inspektimi dhe raportimi mbi gjendjen e laboratorëve, me publikim transparent të progresit.
4. Prioritet buxhetor – ndarje e një pjese të posaçme të **buxhetit arsimor** për pajisjen dhe mirëmbajtjen e laboratorëve si investim **strategjik** për të ardhmen e arsimit në Lezhë.

NGA PYETËSORI

A zhvillohen orët e shkencave të natyrës (kimi, biologji, fizikë) në laboratorë të pajisur?

- Po, gjithmonë dhe me mjete të mjaftueshme për eksperimente.
- Po, por vetëm ndonjëherë dhe me mungesë pajisjesh.
- Rrallë, për shkak të mungesës së laboratorëve të pajisur.
- Jo, orët zhvillohen në klasë pa përdorur laboratorë.



#6

Rivendosja & transparenca e bursave të ekselencës në arsimin parauniversitar

Ligji nr. 69/2012 "Për arsimin parauniversitar" (i ndryshuar) parashikon në disa nene të tij se nxënësit që arrijnë rezultate të larta në mësime përfitojnë bursa ekselence, të cilat jepen nga fondet publike.
Konkretisht, ligji e njeh detyrimin për të stimuluar dhe motivuar nxënësit ekselentë, përveç mbështetjes sociale.

Në praktikë, këto bursa duhet të shpallen me vendim bashkie ose me udhëzim të Ministrisë së Arsimit, por shpesh nuk zbatohen ose mungon transparenca në kriteret, procedurat dhe listat e fituesve.

Prej rreth 5 vitesh nuk është bërë shpërndarje efektive e bursave të ekselencës në Lezhë, duke i lënë pa mbështetje nxënësit me rezultate më të larta.
Mungesa e bursave dobëson motivimin për arritje akademike dhe i shtyn nxënësit të shohin alternativën e studimeve jashtë vendit.

1. Transparencë – **publikim** i kritereve, procedurave dhe listave të përfituesve.
2. Rivendosje – rifillimi i **skemës së bursave** që nga viti 2025–2026, duke mbuluar edhe boshllëkun e viteve të fundit.
3. Mbështetje e qëndrueshme – linjë **e dedikuar** buxhetore në Planin 2026–2028.
4. Monitorim i pavarur – përfshirja e këshillit të nxënësve dhe shoqërisë civile për **drejtësi** dhe **llogaridhënie**.

Rekomandim mbi nevojën për objektiva të matshme & afate konkrete në Planin e Arsimit Parauniversitar 2026–2028

#7

Objektiva të matshëm – çdo qëllim të shoqërohet me **tregues numerikë** (p.sh. shkolla me sisteme sigurie, % e nxënësve me transport falas, numri i bursave).
Afate të qarta – përcaktim i **kalendarit vjetor** të zbatimit 2026–2028.
Raportim publik – **publikim** çdo vit i progresit në faqen zyrtare dhe regjistrin elektronik.
Monitorim i hapur – **përfshirja** e shoqërisë civile, nxënësve dhe prindërve për **transparencë** dhe **llogaridhënie**.

Nga shqyrtimi i draftit aktual të planit rezulton se dokumenti mbetet kryesisht në nivel synimesh të përgjithshme dhe parimesh orientuese. Ai nuk parashikon indikatorë të matshëm, shifra konkrete, apo afate kohore të qarta për realizimin e objektivave.

Kjo krijon vështirësi në:

1. Monitorim – nuk dihet se si do të matet progresi për secilin prioritet.
2. Llogaridhënie – qytetarët, nxënësit dhe prindërit nuk kanë instrument për të kontrolluar përmbushjen e premtimeve.
3. Transparencë – mungon qartësia se kur dhe si do të arrihen ndryshimet e parashikuara.